



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 03.09.2026

PROCESVERBAL

**Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.) për
Draftin e Buxhetit për vitin 2027
I mbajtur më 24.08.2026 (e hënë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.) për Draftin e Buxhetit të vitit 2027 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën **11.08.2026**.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Kalendari-i-protokolluar-shqip.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Kalendari-i-protokolluar-boshnjakisht.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/195CGZEmkD/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1D8e7pPWMb/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Njoftimi-i-protokolluar.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:00** dhe ka përfunduar në **ora 11:35**.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **16 pjesëmarrës, prej tyre 0 meshkuj dhe 16 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini, i cili i ka përshëndetur të pranishmit.

Bexhet Xheladini: Ne e kemi përgatitur Buxhetin paraprak, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, legjislacionit në fuqi të pushtetit lokal dhe sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Buxheti i vitit 2027, në total do të jetë **14,043,470 euro**, pra pak më i lartë se vitin e kaluar. Për Paga dhe Mëditje do të jenë **7,296,248 euro**; për Mallra dhe Shërbime do të jenë **2 milionë euro**; për Shpenzime Komunale **400 mijë euro**; për Subvencione dhe Transfere **591 mijë euro**; për Investime Kapitale do të jetë **3,742,000 euro**.

Qëllimi i debatit publik për Buxhetin është që të njoftohen qytetarët e Komunës sonë, sepse ky buxhet do të realizohet në të mirë të tyre dhe me qëllim që të përmirësohen shërbimet komunale. Gjithashtu, të bëhet edhe realizimi i projekteve kapitale sipas kërkesave të komunitetit. Unë nuk dua të zgjatem më shumë për fillim. Këtu e kam dhe drejtorin e Buxhetit, nëse don me e marrë fjalën?

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Përshëndetje për të gjithë! Diçka të veçantë nuk kam çka të shtoj, është me rëndësi që gratë dhe vajzat, si grupe të nënpërfaqësuar, të kenë ndonjë iniciativë. Këto për çdo ditë hasin në probleme, të cilat përmes iniciativave mund t'i zgjidhim bashkërisht. Është mirë që t'i propozoni kërkesat tuaja dhe ne t'i mbështesim me buxhet në vazhdimësi këto iniciativa. Ju falënderoj edhe një herë për kohën që keni gjetur të merrni pjesë në këtë takim! Edhe pse nuk jemi në pozitë shumë të favorshme, shpresoj se do t'ia dalim që t'i përmbushim kërkesat të cilat do të na paraqiten për vitin 2027.

Uzair Hamza, shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim: Përshëndetje dhe respekt për të gjithë të pranishmit. Unë do t'ju drejtohem shumë shkurt. Më vjen keq që në mesin tuaj nuk ka përfaqësuese gra nga sektori joqeveritar, përveç drejtoreshës për shërbime publike, sa po shoh këtu. Përveç jush, sot janë ftuar edhe përfaqësues të sektorit joqeveritar. Ajo që dua të theksoj dhe që është e rëndësishme për ne është se buxheti, i cili për vitin e ardhshëm kap shumën prej 14 milionë eurosh, është ndarë në përputhje me përqindjen e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë që jetojnë në komunën tonë. E kemi theksuar disa herë se në disa segmente kjo përqindje është madje edhe më e lartë sesa përqindja që aktualisht përbëjmë ne. Nuk do të doja të flisja për detaje. Vetëm do t'u bëja apel përfaqësuesve të organizatave joqeveritare, si përfaqësuesve gra, ashtu edhe përfaqësuesve të sektorit joqeveritar, që të jenë të informuar, të ndjekin dhe të marrin pjesë në takime, dhe jo të shkruajnë në rrjetet sociale se ne, në njëfarë mënyre, jemi të diskriminuar dhe se nuk kemi buxhet të mjaftueshëm nga institucionet

komunale. Konsideroj dhe i ftoj edhe një herë përfaqësuesit e komunitetit joqeveritar që të përfshihen më aktivisht në jetën shoqërore dhe politike të institucioneve të komunës dhe të Kosovës, dhe, në të njëjtën kohë, të paraqesin më aktivisht kërkesa për projektet e tyre në kuadër të sektorit të tyre, përkatësisht organizatës së tyre joqeveritare. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ne çdo herë ndarjen e buxhetit e kemi bërë në bazë të përqindjes së popullsisë. Ka raste kur e kemi tejkaluar edhe këtë proporcion. Por, buxheti i vitit 2027 është ndarë në proporcionin 60% për shqiptarë dhe 40% për komunitete joshumicë. Normal, në Dragash e kemi buxhetin e përbashkët dhe këtu, në mënyrë proporcionale, e ndajmë buxhetin, sepse këtu jetojnë të tri komunitetet. Kështu që, ne bëjmë një apel, të gjithë ata të cilët po mundohen të bëjnë përçarje dhe propaganda, që t'i ndalojnë këto, sepse këtë liri, pavarësinë dhe çlirimin e kemi arrit bashkë, dhe nuk do të lejojmë assessi që dikush, këtë harmoni që e kemi krijuar në mes të komuniteteve që jetojnë në Komunën e Dragashit, ta prishin me këso lloj propaganda të ulëta. E kanë të kotë, por megjithatë, ne jemi të obliguar që t'i njoftojmë qytetarët tanë me fakte dhe argumente. Gjithashtu, dua t'ju them se ne kemi shumë probleme me qeverinë qendrore. Këtë vit, në bazë të qarkoreve buxhetore që kemi marrë, buxheti për Investime Kapitale është afër 900 mijë euro më i vogël se vitin e kaluar. Arsyeja është sepse vitin e ardhshëm Qeveria e Kosovës nuk do të ndajë mjete për stafin e arsimit në bazë të numrit aktual të punëtorëve, por do të ndajë mjete në bazë të numrit të nxënësve, dhe në këtë drejtim, ne kemi marrë urdhëresë nga Qeveria që 115 punëtorë të arsimit t'i largojmë prej listës së pagave, që nga 3 janari. Kërkesa e tyre ka qenë që, nëse keni buxhet tuajin, mbani, nëse nuk keni, duhet t'i largoni. Kjo është diçka jonormale, joligjore, dhe ne nuk jemi të pajtimit që këta punëtorë, nga 3 janari i vitit 2027 të largohen nga puna. Por, ne kemi bërë një marrëveshje të brendshme, dhe kemi vendos që vitin e ardhshëm këta punëtorë të mos largohen nga puna. Këta do të mbulohen nga buxheti i Komunës, jo nga buxheti i Qeverisë së Kosovës, siç ka qenë më herët. Gjithashtu, ju e dini që Ligjin e Pagave e ka përgatit kjo Qeveri, dhe aty koeficienti i stazhit të punës është ulur nga 0.5 në 0.25. Pas ankesave të sindikatave, është fituar gjyqi dhe Qeveria tash është e obliguar që ta kthejë atë 0.5, dhe është e obliguar që këtë ta bëjë me mjete të Qeverisë qendrore. Por, me Qarkoren e dytë që na ka dërguar, edhe këto mjete prapë na i ka marrë komunave. Kështu që, prapë do të kemi edhe më pak shpenzime kapitale dhe këto mjete Qeveria vetë i ka qit në buxhetin e pagave, që është një padrejtësi. Kështu që, ne, kryetarët e komunave, javën e kaluar kemi mbajt një takim dhe kemi marrë një qëndrim që, më 1 shtator, në ora 11:00, të shkojmë dhe të protestojmë para qeverisë për të drejtat tona, sepse vazhdimisht kjo qeveri është duke na i marrë kompetencat e nivelit lokal. Do të kundërshtojmë për kontratën kolektive, të na i kthejë ato mjete që na i ka marrë – diku afër 350 milionë euro ua ka marrë komunave, qeveria. Gjithashtu, do të protestojmë edhe për pagesën e dëmeve të vërshimeve që janë

bërë në Komunën tonë. Derisa kjo Qeveri ka ndarë mjete për vërshimet në Bosnjë, e nuk ka ndarë për Komunën tonë, kjo është një padrejtësi që iu ka bërë qytetarëve tanë, kështu që ne atë ditë do ta bëjmë edhe këtë kërkesë. Siç thashë, qëllim i këtij takimi është të ju njoftojmë me buxhetin, por edhe të marrim kërkesa nga ju. Nëse nuk keni kërkesa për projekte konkrete, mund të jepni ide, pastaj ne ato i shndërrojmë në kërkesa. Kështu që, tash po jua kaloj fjalën juve!

Lindita Kozmaqi Piraj, zyrtare për Barazi Gjinore: Përshëndetje për të gjithë! Duke marrë parasysh të gjitha ato vështirësi që i ceki kryetari, duke ia shtuar edhe të hyrat e vogla që i ka Komuna jonë, fatkeqësisht, kjo na i shkurton mundësitë që të mund të realizojmë dhe të përmbushim konkretisht diçka për vitin e ardhshëm, që ka të bëjë direkt me gratë e vajzat dhe realizimin e të drejtave të tyre. Dhe që besoj se janë shumë. Edhe pse numri është këtu i pakët, apo hezitojnë me i shpreh, ne të gjithë e dimë që kemi nevoja të mëdha. Një nevojë që është akumuluar prej viteve, është problematika e transportit, jo vetëm Dragash-Prizren. Pas ardhjes së kryetarit, i është bërë menjëherë një kërkesë, e kemi marrë përgjigjen që ka bo përpjekje kryetari në nivel qendror – për arsye se kjo i takon nivelit qendror – por ne e kemi edhe një problematikë sa i përket transportit nga fshatrat në Dragash dhe anasjelltas. Në pamundësi të linjave të rregullta, ne nuk mund të kemi edhe aktivitete konkrete apo edhe gra aktive, sepse shumë mirë e dimë që, me një organizimin e një takimi më të vogël, gratë apo vajzat tona, përkundër dëshirës edhe vullnetit me qenë prezent në Dragash, nuk kanë pas mundësi për shkak të transportit. Kështu që, nëse kishim mundur që të planifikojmë diçka në të ardhmen, në qoftë se jo me forca të komunës, të paktën me fillu ndonjë lëvizje, ndoshta për ta bërë të mundur edhe nga donatorët, ndonjë linjë më e shpeshtë, përveç këtyre që janë. Gjithmonë në të kaluarën, në takimet nëpër fshatra me gratë, ka qenë brenga më e madhe transporti. Pastaj e kemi Çerdhen, e pashë një konkurs që është hap, ndoshta është mirë me na njoftu konkretisht, a do të jetë siç ka qenë më parë, apo kemi fillu me diçka konkrete, tërëditore, për këto grupmosha. Edhe shërbimet shëndetësore, ne e dimë shumë mirë që si Komunë, falë përpjekjes së kryetarit edhe mbështetjes së donatorëve, kemi pas vitet e fundit disa shërbime, posaçërisht për gratë, që ua kemi mundësuar në QKMF. Midis tjerash, ka qenë edhe Papa Testi falas. A ka diçka lëvizje në këtë drejtim, apo do të vazhdohet me ato shërbime që kanë qenë. Përveç këtyre, unë kisha si propozim, duke e pas parasysh se ne kemi punuar dy vjet radhazi me organizatën që ka qenë edhe Komuna, me ASB-në. E keni Qendrën e Grave të financuar dhe të rregulluar në Dragash, nga ana e ASB-së. Gjatë këtyre muajve ne, me takimet të cilat i kemi mbajtur këtu me gratë, edhe në terren, kemi dalë në konkluzion me disa pika që do të ishte mirë që t'i shtyjmë, për komunitetin e grave dhe vajzave, mbështetjen edhe mirëqenien e tyre. Një prej pikave nuk ka të bëjë fare me buxhet të posaçëm, përjashtim se me e bo një amandamentim të Rregullores së Subvencioneve, që për kategorinë e grave dhe vajzave që aplikojnë për subvencione në bujqësi,

ndërmarrësi apo në biznes, që fatkeqësisht në Komunën tonë kemi shumë pak, për mos me thënë fare, që hapen biznese të reja, përjashtim qato që janë qe disa vjet – frizere apo ndonjë rrobaqepëse – edhe nuk e di sa kemi edhe fermere, po disa janë. Kështu që, ato kur të aplikojnë për subvencione, me e pas njëfarë mbështetje – ndoshta për 5 pikë – vetëm pse janë gra, domethënë, me e bo një ndryshim të Rregullores ekzistuese për Subvencione, që gratë kur të aplikojnë me i pas edhe 5 pikë shtesë, për shkak të pozitës në të cilën gjenden, që kemi shumë pak gra dhe është në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi. Një propozim tjetër, që ka të bëjë me mbështetjen e grave dhe mirëqenien e tyre – për prindërit, por jo vetëm për gratë, por duke e pas parasysh që gratë mbesin për një kohë të gjatë prindër vetushqyes – mbështetja e tyre me financa mujore. Domethënë, ne me dalë me një rregullore – kisha dashtë që edhe asambleistët me qenë këtu prezente – ta kemi si opsion edhe mundësinë e mbështetjes së ndonjë organizate, me një shumë financiare, aq sa ka hapësirë, t’i mbështet këto raste të prindërve vetushqyes. Ta bëjmë një rregullore dhe ta shtyjme si program për herë të parë në Komunë, megjithëse komunat tjera kanë fillu me programe të ndryshme. Sipas të dhënave të QPS-së, në Komunën tonë i kemi vetëm 16 prindër vetushqyes. Nuk kemi shumë raste, për fat të mirë. Edhe pse edhe kjo i kushton Komunës, mirëpo unë kisha thënë që të fillojmë, për me tregu ne që jemi një Komunë me një qasje pro realizimit të të drejtave të barabarta. Të fillojmë me një shumë simbolike, ndërsa në të ardhmen, varësisht prej buxhetit, mund ta ngremë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Atëherë, unë do t’i përgjigjem në pika të shkurtëra zyrtares për Barazi Gjinore. Sa i përket udhëtimit Dragash-Prizren, unë si kryetar i Komunës i kam kryer të gjitha obligimet. Kam bërë marrëveshje edhe me kryetarin e Prizrenit, e kam dërguar kërkesën edhe në ministrinë përkatëse. Kam qenë edhe personalisht tri herë në Ministri të Infrastrukturës. I kam thirrë në telefon ndoshta nja 20 herë. Nuk ka pasur vullnet zëvendësministri me e nënshkrue. Pse? Nuk po e di edhe ai zyrtari që merret me këtë çështje. Unë mund ta riaktualizoj prapë këtë çështje. Sa i përket udhëtimit brenda territorit, në pjesën e Opojës është e rregulluar disi, vetëm në pjesën e komunitetit joshumicë nuk ka, por çështja e transportit brenda Komunës duhet të rregullohet duke pasur kompani të interesuar që e bëjnë një gjë të tillë. Kompanitë e kanë bërë llogaritjen e vet, nuk kanë llogari. Unë kam pas takime e biseda dhe asnjë kompani nuk do me hy kështu. Sa i përket Çerdhes në Dragash, për momentin do të vazhdojë si vitin e kaluar. Ju e dini që është duke u ndërtuar edhe një çerdhe në Bresanë, e cila është në ndërtim e sipër, unë nuk besoj që ajo mundet me u lëshue në punë këtë vit. Por vitin e ardhshëm, sigurisht se në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, do të bëhet edhe hapja e asaj çerdheje. Kështu që, do të ketë kapacitet të mjaftueshëm për të gjithë ata të cilët janë të interesuar që t’i çojnë fëmijët në çerdhe. Sa i përket mbështetjes për gratë, unë si kryetar vazhdimisht e kam mbështetur komunitetin e grave dhe vajzave,

edhe në punësim, por edhe në pozita, sepse ju e dini që kjo Komunë kurrë nuk ka pas drejtoresha dhe gra në pozita udhëheqëse. Me ardhjen tonë si qeveri komunale, e kemi bërë këtë. Gjithashtu, në punësim, në arsim dhe shëndetësi, pjesën më të madhe i kemi bërë nga komuniteti i grave dhe vajzave. Tash kemi filluar një gjë të tillë ta bëjmë edhe në Komunë. Unë besoj që ne jemi duke bërë përpjekje që ta ndihmojmë komunitetin e grave dhe vajzave. Edhe në shëndetësi, ju e dini, e kemi siguruar gjinekologun, i cili është duke punuar me orar të plotë. Po ashtu edhe Papa Testin, që do të vazhdojmë ende ta ofrojmë si shërbim. Presim që së shpejti të na kthehet edhe gjinekologjia nga specializimi. Te ndarja e bursave, vitin e kaluar kur i kemi ndarë bursat, mbi 70% të bursave kanë qenë për vajzat. Po ashtu, kemi qenë të interesuar që edhe OJQ-të e themeluara nga gratë t'i mbështesim. Sot kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me një OJQ të grave, ku atyre do t'u ofrojmë kushte për punë, gjithashtu do t'ua mbulojmë edhe disa shpenzime të vogla, por edhe do ta financojmë këtë OJQ duke u bazuar në thirrje publike dhe ligji. Kësaj OJQ-je i dëshiroj punë të mbarë, do ta ketë mbështetjen e Komunës, për aq sa na lejon ligji. Për nënat vetushqyese, edhe pse është numri i vogël i tyre, por nëse atë e shumëzojmë me 12, duhet shumë mjete financiare dhe këtë nuk na lejon ligji, sepse nënat vetushqyese i rregullon ligji përmes nivelit qendror. Kështu që, aktualisht por edhe vitin e ardhshëm këtë nuk mund ta bëjmë, për shkak se kemi jashtëzakonisht probleme të mëdha me buxhetin, dhe, siç thashë edhe në fillim, do të protestojmë, për arsye se qeveria po na i merr mjetet tona. Sivjet, deri më tash na i ka marrë afër 400 mijë euro. Edhet atë na i ka marrë nga Mallrat dhe Shërbimet, dhe do ta kemi shumë vështirë me gjet mjete me ble dru, pelet dhe naftë për nxemje. As vetë nuk e dimë se ku do të mund t'i gjejmë këto mjete. Kështu që, për momentin këtë kërkesë nuk mund ta realizojmë, por këtë është duke e realizuar QPS-ja. Ne do t'u bëjmë edhe lehtësime tjera kësaj kategorie të grave, nënave vetushqyese. Besoj se ju përgjigja të gjitha pyetjeve.

Nëse nuk ka edhe dikush që dëshiron ta marrë fjalën, ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: [https:// dragash.rks-gov.net/ news/ komuna-e-dragashit-ka-permbyllur-procesin-e-organizimit-te-degjimeve-buxhetore-per-draftin-e-buxhetit-komunal-per-vitin-2027/](https://dragash.rks-gov.net/news/komuna-e-dragashit-ka-permbyllur-procesin-e-organizimit-te-degjimeve-buxhetore-per-draftin-e-buxhetit-komunal-per-vitin-2027/)

Boshnjakisht: [https:// dragash.rks-gov.net/ sr/ news/ opstina-dragas-je-zavrshila-proces-organizovanja-budzetskib-javnib-rasprava-o-nacrtu-opstinskog-budzeta-za-2027-godinu/](https://dragash.rks-gov.net/sr/news/opstina-dragas-je-zavrshila-proces-organizovanja-budzetskib-javnib-rasprava-o-nacrtu-opstinskog-budzeta-za-2027-godinu/)

Në Facebook:

Shqip: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 1BzSWVRGdP/](https://www.facebook.com/share/p/1BzSWVRGdP/)

Boshnjakisht: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 1HR3MGU1gX/](https://www.facebook.com/share/p/1HR3MGU1gX/)

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/01-18905/86/1
24.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 24.08.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragash

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME GRUPE TË
NËNPËRFAQËSUARA (GRA, VAJZA, PËRFAQËSUES TË
KOMUNITETIT JOSHUMICË, PENSIONISTË, PERSONA ME NE VOJA
TË VEÇANTA ETJ.)

LISTA UÇESNIKA NA BUDŽETSKO SASLUŠANJE SA NEDOVOLJNO
ZASTUPLJENIM GRUPAMA (ŽENE, DEVOJKE, PREDSTAVNIKE I
NEVEČINSKE ZAJEDNICE, OSOBE SA POSEBNIM POTREBAMA ITD.)

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	Rajda Jahani Jemazi	Maleša	GORANICA		ž	Rajda J.I.
2	Ameda Mehmeti	Zgatare	Shqiptare		✓	Mehmeti
3	VALDETE UKA	BELA S	SHQIPTARE		✓	Valdete U.
4	Medine Gajti	Bresanë	Shqiptare		✓	Medine G.
5	Ljupita Pijeraj	Dragash	Shqiptare		✓	Ljupita P.
6	Hammete Jhalbani	Dragash	Shqiptare		✓	Hammete J.
7	Sabrie Kolloni	Kosovë	Shqiptar		✓	Sabrie K.
8	ELA QAFLESHI	BELLOBRAD	SHQIPTAR		✓	Elza Q.
9	Sihana Ramadani	Dragash	Shqiptare		✓	Sihana R.
10	ARIJETA QALLORE	ZYTI	SHQIPTARE		✓	Arijeta Q.
11	Sara Destani	Vranjska	GORANICA		✓	Sara D.
12	Vlera Pirci	Pllave	Shqiptare		✓	Vlera P.
13	Semina Misini	Shajne	Shqiptare		✓	Semina M.
14	Merybe Ramadani	Zaplluxhë	Shqiptar		✓	Merybe R.
15	Arifete Jusufi-Gaji-Ka	Brezane	Shqiptare		✓	Arifete J.
16	Arifete Jusufi	Krenec	Shqiptare		✓	Arifete J.
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						



